



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.
_____._____.2020

Burrel, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “ALIAJ-79” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L47521901E**

Adresa: *Dibër, Lis, Zenisht, Rruga “Ruçi”, Ndërtesë private 1-katëshe, përballë xhamisë*

Procedura e prokurimit: “**Kërkesë për Propozim - Punë**”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-56484-04-21-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Riparim dhe mirëmbajtje kanale vaditëse**”, me fond limit: **7 375 435** (shtatë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin **2020** në vlerën: **4 066 430** (katër milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **lekë pa TVSH** nga grandi, ndërsa për vitin **2021** në vlerën: **3 309 005.83** (tre milion e treqind e nëntë mijë e pesë pikë tetëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH** nga grandi, me afat realizimi të punimeve: **30** (tridhjetë) **ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 22 datë 27 Prill 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “**EGLAND**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J96829419D**
Vlera: **6 899 920** (gjashtë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) **lekë pa TVSH**
2. Operatorin Ekonomik: “**ALIAJ-79**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L47521901E**
Vlera: **7 334 050** (shtatë milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**
3. Operatorin Ekonomik: “**Vllaznia Ndertim I.S**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K77524909Q**

Vlera: *Nuk ka paraqitur ofertë.*

4. Operatorin Ekonomik: “EA Engineering” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L975229010**

Vlera: *Nuk ka paraqitur ofertë.*

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “Vllaznia Ndertim I.S” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K77524909Q**
2. Operatorin Ekonomik: “EA Engineering” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L975229010**
3. Operatorin Ekonomik: “EGLAND” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J96829419D**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejtë se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: “Vllaznia Ndertim I.S” sh.p.k, **nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (sipas Shtojcë 1 të DST-së)** në zbatim të nenit 17 të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “***Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik***” (i ndryshuar), **si dhe të gjitha dokumentat e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit,**
 - ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejtë se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: “EA Engineering” sh.p.k, **nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (sipas Shtojcë 1 të DST-së)** në zbatim të nenit 17 të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “***Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik***” (i ndryshuar), **si dhe dokumentat e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit,**
 - ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “EGLAND” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se **nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**
- I. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**
Ofertuesi duhet të deklarojë se: ...
Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.
Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi deklarata e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik nuk është e plotësuar sipas formës së kërkuar në shtojcën 4 e përcaktuar në DST-së, si dhe data e dorëzimit të deklaratës i përket një periudhe përpara datës së publikimit të procedurës së prokurimit.**
- II. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “f” / 2.**

Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:**

- **Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1 nuk është sipas formatit të kërkuar dhe se i referohet një lloji tjetër procedure prokurimi.**
- **Deklarata për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1 nuk është sipas formatit të kërkuar, ku i mungon dhe përcaktimi i fondit limit të procedurës së prokurimit objekt prokurimi, si dhe nuk është shënuar (klikuar) në pikën 6 të saj alternativa e përgatitjes së ofertës nga ana e tij.**
- **Deklarata mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1, Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6 dhe Deklarata mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7 nuk janë sipas formatit të kërkuar, ku u mungojnë dhe përcaktimi i fondit limit të procedurës së prokurimit objekt prokurimi**
- **Nuk është paraqitur Deklarata mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4/ 2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar: /

2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2018 dhe 2019 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, në Vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Bulqizë për shlyerjen e taksave për vitin 2019 është shënuar se ka shlyer detyrimet vetëm për tarifën e pastrimit dhe jo për të gjitha taksat e vitit 2019.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

- *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% (që i korrespondon vlerës 3 687 717 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** (që i korrespondon vlerës 14 750 868 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :

- Kontratën e Sipërmarrjes,
- Situacionin përfundimtar të objektit
- Faturat Tatimore
- Aktin e Kolaudimit të objektit
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8

b) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- Kontratën e Sipërmarrjes,
- Situacionin përfundimtar të objektit
- Faturat Tatimore
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zërat kryesore të punimeve kanë volume të konsiderueshme krahasimore të përcaktuara në këtë prokurim.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, Faturat Tatimore Shitje për të dyja investimet e paraqitura për përmbushjen e këtij kriteri, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor, si dhe janë të pafirmosura nga ana e investitorit (*blerësit*) Bashkia Bulqizë për punimet e kryera.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Për Listën e mëposhtme të artikujve:

- Tub i brinjëzuar me 2 shtresa “HDPE” SN4 Ø 315mm
- Tub i brinjëzuar me 2 shtresa “HDPE” SN4 Ø 400mm
- Tub i brinjëzuar me 2 shtresa “HDPE” SN4 Ø 500mm
- Tub i zi Ø 90mm 6 A

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit për listën e mësipërme të mallrave lëshuar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit.** Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website,

kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2. **Certifikatën** që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit/ prodhuesve është sipas standartit **ISO 9001:2015** për listën e mësipërme të mallrave, e vlefshme.
3. **Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve** në gjuhën angleze për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk janë paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për listën e artikujve të kërkuar.**

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “b” të pikës 2.3.4/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

a) *Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojë si drejtues teknik me licencën e shoqërisë dhe në listëpagesat e shoqërisë:*

- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi**

- *Për inxhinierin pjesë e stafit të cilin duhet detyrimisht të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet Kontratë noteriale pune (me kohë të plotë) me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt, Diplomë + CV, si dhe një eksperiencë pune mbi 5 vjet.*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, kontrata e paraqitur për inxhinierin e ndërtimit nuk është kontratë noteriale pune sipas kushtit të kërkuar.**

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë “Njësi Magazinimi” në territorin e Bashkisë Mat. Për vërtetimin e saj, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Leje lëshuar nga QKL - Kodi: III.1.A - Leje mjedisore Tipi C;*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, Leja mjedisore (kodi: III.1.A) lëshuar nga QKL është në emër të subjektit: Egländ dhe me adresë në: Dibër, Bulqizë, Shupenzë, Zogaj, fshati Zogaj. Zyra te ndërtesa pranë fabrikës së mermerit/ Zogaj dhe jo në territorin e Bashkisë Mat, ndërsa për subjektin me të cilin është lidhur kontrata e furnizimit me objekt:**

“Shërbim magazinimi” i cili bazuar në ekstraktin e QKR-së ka adresën në: *Dibër, Komsì, Komsì, rruga Batre, kompleksi RAMI, Komuna Komsì Mat*, rezulton se nuk disponon Leje mjedisore (kodi: III.1.A) lëshuar nga QKL për njësinë e tij.

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe pajisjet (*sipas tabelës*) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit	Sasia
1.	Matrapik	1 copë
2.	Kamiona vetshkarkues (4 x 4) me vinç, jo më pak se 7 ton	1 copë
3.	Betoniere 0.33 m ³	3 copë
4.	Kamioncine mbi 1 ton peshe mbajtese	2 copë
5.	Kallëperi	380 m ²
6.	Saldatriçe	1 copë
7.	Vibratore betoni	2 copë
8.	Depozitë Uji (jo më pak se 2000 litra)	2 copë
9.	Pajisje për ngjitje tubi me elektrofuzion	1 copë
10.	Tokmak elektrik për ngjeshje dheu	2 copë

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se, nuk disponon mjet: Kamioncine mbi 1 ton peshe mbajtese (2 copë) dhe pajisjen: Depozitë Uji (jo më pak se 2000 litra) (2 copë).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “**ALIAJ-79**” Sh.p.k, me seli: *Dibër, Lis, Zenisht, Rruga “Ruçi”, Ndërtesë private 1-katëshe, përballë xhamisë*, me numër Nipt-i: **L47521901E**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **7 334 050** (shtatë milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **14.05.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR